



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Kuvendi i Kosovës**

**Komisioni për Integritim Evropian**

**Mbledhja nr. 1**

**Prishtinë, më 13. 02. 2008**

**Ndërtesa e Kuvendit, ora 11:00, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Dzezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova, ndërsa munguan: Lutfi Haziri dhe Branislav Grbic.

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Sabiha Shala – Agjencioni për Integritim Evropian ZKM

Albinot Bimbashi – AIE-ZKM

Qemajl Marmullakaj-KIPRED

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit me këtë

**REND DITE**

1. Konstituimi i Komisionit
2. Fushëveprimi i Komisionit për Integritim Evropian
3. Të ndryshme

**1. Konstituimi i Komisionit**

**Zylfije Hundozi**, inaguroi Komisionin për Integritim Evropian i cili kryesohet nga Zylfije Hundozi kryetare e Komisionit, zëvendëskryesuesit Lutfi Haziri e Dzezair Murati dhe anëtarët e Komisionit Hydajet Hyseni nga PDK, Edita Tahiri nga PDK, Sabri Hamiti nga LDK, Fatmir Rexhepi nga LDK, Njomza Emini nga AKR, Nait Hasani nga PDK, Naser Rugova nga LDD dhe Branislav Grbic nga SLS.

## 2. Fushëveprimi i Komisionit për Integritime Evropiane

**Zylfije Hundozi**, fillimisht kërkoi falje, për mos shpërndarjen me kohë të propozimit të fushë veprimtarisë së Komisionit nga stafi. Lidhur me propozimin për fushëveprimtarinë e Komisionit tha se, pas pavarësisë së Kosovës një ndër prioritetet e institucioneve të Kosovës do të jetë integrimi në institucionet evropiane. Komisionin e pret një punë e madhe për përshpejtimin e integritimit të Kosovës në institucionet Evropiane e gjithashtu edhe institucionet e Kosovës kanë për obligim që të bëjnë reforma në shoqërinë Kosovare, për aderimin sa më të shpejtë të Kosovës në institucionet evropiane. Në vazhdim shtoi se, si Komision parlamentar do të përqendrohemi në fushën legjislativë dhe në fushën politike të Komisionit. Në fushën e legjislativës tha se është një punë e madhe ku duhet të bëhet harmonizimi i të gjitha ligjeve që procedohen për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës, me Acquis Communautaire.

Si fushëveprimtari e Komisionit tha se propozojmë të jetë, harmonizimi i sistemit juridik të Kosovës me sistemin juridik të BE-së si parakusht për integrimin e Kosovës, në institucionet evropiane.

Sa i përket aspektit politik shtoi se, ky Komision një ndër pikat e fushëveprimtimit do të ketë kooperimin dhe koordinimin me institucionet evropiane në përgjithësi, e edhe me institucionet evropiane të cilat i kanë përfaqësuar e veta në Kosovë siç është: AER-i, Zyra ndërkombëtare Civile përkatësisht e përfaqësuesit special të BE-së në Kosovë, Kryesinë Evropiane dhe Misionin e BE-së për monitorim.

Fushëveprimtari e Komisionit tha se do të jetë edhe monitorimi i Qeverisë mbi detyrat e saja lidhur me integrimin në BE; mbikëqyrjen e implementimit të Planit të Veprimtimit për Partneritet Evropian; participimi dhe mbikëqyrja në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit të Kosovës; mbikëqyrja dhe koordinimi në procesin e parapërgatitjes për hyrje në BE; monitorimi i programeve donatore të kooperimit të BE-së të dedikuara për Kosovën; bashkëpunimi me shtetet e reja të BE-së nga regjioni për shkëmbimin e përvojave lidhur me etapat nëpër të cilat kanë kaluar për integrimin e tyre në BE; bashkëpunimi me Këshillin e Evropës, meqë i kemi pranuar disa parime nga Këshilli i Evropës si dhe mbikëqyrja e të gjitha marrëveshjeve që do të dalin nga bashkëpunimi i Kosovës me Këshillin e Evropës.

**Hydajet Hyseni** lidhur me propozimin për fushë veprimtarinë e Komisionit tha se, do të ishte mirë që ta analizojmë së pari, e pastaj në mbledhjen e ardhshme të Komisionit ta miratojmë. Meqë ky Komision ka qenë pjesë e Komisionit të jashtëm është me rëndësi që të qartësohet fushë veprimtaria e tij, që të mos ndodhin duplikime e inerfenime.

Si synim parësor i Komisionit tha se duhet të jetë procesi i integritimit evropian të Kosovës në gjithë përfshirje, e pastaj sistemi juridik të jetë një nga fushat e fokusimit të Komisionit tonë. Në vazhdim shtoi se nga AIE-ne, nga zyrat për integritime të ministrive, e po ashtu edhe nga Komisioni për bashkëpunim me jashtë dhe integritime euro-atlantike do të ishte mirë të kishim një informatë se çka është punuar gjerë më tani, që të kemi një vazhdimësi pune.

**Zylfije Hundozi** tha se ekzistojnë oferta të disa organizatave joqeveritare për ndihmë të këtij Komisioni, një nga ato është edhe oferta e KIPRED-it.

**Qemajl Marmullakaj** nga KIPRED-i tha se ne i kemi ofruar bashkëpunim Komisionit, ku fillimisht do t'i bënim një analizë të përgjithshme gjithë procesit të integritimeve evropiane. Një sferë tjetër e rëndësishme ku do të mund t'i asistojmë këtij Komisioni, tha se është edhe analiza legjislativë.

KIPRED-i do të mund të organizonte dëgjime publike, e po ashtu shtoi se është i rëndësishëm rrjetëzimi i këtij Komisioni me institucionet vendore, ndërkombëtare e rajonale, ku do të mund të inicioheshin trajnime në bashkëpunim me Komisionin Evropian për stafin dhe anëtarët e Komisionit .

**Dzezair Murati** për fushë veprimtarinë e Komisionit propozoi që projekti i ofruar të analizohet, që në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të jemi të gatshëm ta miratojmë.

Njëkohësisht propozoi që të caktohet një termin i saktë për mbajtjen e mbledhjeve të Komisionit.

**Zylfije Hundozi** njoftoi anëtarët e Komisionit se nga NDI-a me të cilët ne bashkëpunojmë qe disa vite, është ofruar një memorandum bashkëpunimi për ndihmë të Komisionit në: hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit vjetor të punës; monitorimin e zbatimit të ligjeve; rritjen e kualitetit të dëgjimeve publike; identifikimin dhe angazhimin e eksperteve vendor dhe rajonal; përgatitjen e raporteve vjetore dhe publikim e buletinit informativ.

Në vazhdim shtoi se kemi edhe një ofertë nga Instituti për Studime të Avancuara GAP, e cila në formë të shkruar iu shpërnda anëtarëve të Komisionit .

**Naser Rugova** propozoi që Agjencioni për Integritet Evropian ta informoj Komisionin me një raport me shkrim për punët që janë bërë gjerë më tani. Në vazhdim shtoi se, duke pas parasysh se pranë ZKM-ës ka qenë edhe zyra e koordinorit të Paktit të Stabilitetit, i cili i ka përcjellë në kontinuitet të gjitha veprimet duke filluar nga Komisioni Evropian, mbledhjet e mekanizmit përcjellës të stabilizimit asociativ nga të cilat kanë dalë vendime të rëndësishme, propozoi që të na përcillet ndonjë material apo konkluzë e mbetur aty.

Njëkohësisht tha se duhet ti kemi prioritetet e Agjencionit për vitin 2008 konform rrjedhave në të cilat po hymë si Kosovë, një raport të karakterit informativ për aktivitetet e ndërmarra në PVPE, të njoftohemi me aktivitetet që kanë të bëjnë me instrumentet e para aderimit si dhe në çfarë faze të zhvillimit janë institucionet e Kosovës me institucionet gjegjëse Evropiane.

Në fund shtoi se është e nevojshme një asistencë e përhershme profesionale që do ta mbështeste këtë Komision në vazhdimësi.

**Edita Tahiri** tha se pajtohet që projekti inicial për fushë veprimtarinë e Komisionit të miratohet në mbledhjen e ardhshme dhe propozoi një preambulë me të cilën përfshihet misioni i këtij Komisioni në përputhje të plotë me synimet e Parlamentit dhe të Qeverisë së Kosovës për tu bërë pjesë e BE-së, me një karakter ideologjik, për të cilin tha se do ta plotësoj dhe do ta sjell në mbledhjen e ardhshme. Përkrah mendimin e N. Rugovës lidhur me raportin nga AIE-ne dhe shtoi se është mirë të bëhet një analizë që të kemi një pikë reference, se ku është pozicioni i Kosovës në trajtimet e institucioneve të BE-së dhe institucioneve parlamentare evropiane. Lidhur me ofertat për mbështetje të Komisionit tha se janë të mirëseardhura por duhet të koordinojmë punën që të shfrytëzojmë ndihmën e tyre në mënyrë sa më racionale.

**Hydajet Hyseni** tha se për punën e Komisionit është e nevojshme të kemi profesionalistë për ndihmë profesionale dhe të kemi për bazë përvojën e shteteve me tranzicion të suksesshëm, e me kushte përafërsisht të ngjashme me tonat. Propozoi që të kërkohen kushte për punën e komisionit, një hapësirë me një librari , duke pas parasysh specifikat e tija.

**Nait Hasani** tha se si hap i parë për harmonizimin e legjislacionit me Acquis Communautaire do të ishte materiali i përkthyer. Në këtë drejtim shtoi se Shqipëria ka dokumentacionin e përkthyer në gjuhën shqipe dhe se duhet parë mundësinë e shfrytëzimit të tij.

Lidhur me fushë veprimtarinë e Komisionit tha se duhet ndarë në plan pune për çdo tre muaj, si dhe të angazhohemi për bashkëpunim me AIE-ne .

**Njomza Emini** përkrahi diskutimin e z. N.Rugovës, që Komisioni të ketë një njoftim lidhur me punën dhe të arriturat e gjertanishme të Agjencionit për Integritet Evropian.

**Edita Tahiri** përkrahi propozimin që Komisioni të ketë një zyrë të veçantë për integritet evropian, duke pas parasysh rëndësinë e Komisionit si dhe tani prezencën e misionit të BE -së në Kosovë.

Komisioni pas këtyre diskutimeve nxori këto

### **P e r f u n d i m e**

1. Mbledhjet e Komisionit për integritet evropian kryesisht të mbahen ditën e hënë.
2. Të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit, që të ndahet një zyrë pune për Komisionin për integritet evropian .

Mbledhja përfundoi në orën 11:55min.

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi